

KRONIKË E ZEZË

Vushtrriasi gjuan me armë në aheng, Policia ia sekuestron



Policia e Kosovës mesditën e së martës ka sekuestruar një armë, me të cilën dyshohet se u gjuajt në një aheng familjar.

Sipas Policisë, në cilësi të provës materiale është sekuestruar arma e shkurtër EKOL, një karikator i zbrazët dhe tri gëzhoja.

“Në cilësi të të dyshuarit është intervistuar B.K., 57 vjeçar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili dyshohet se ka shtënë me armë”, thuhet në njoftim.

Pas intervistimit, i dyshuari është liruar në procedurë të rregullt. Ndaj tij është iniciuar rast për veprat penale “Mbajtje në pronësi, kontroll apo në posedim të paautorizuar të armëve” dhe “Përdorim i armës”.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

20 korrik 2022, 08:50

Shpërndaje në



- Digjet një shtëpi në Drenas, s’ka të lënduar
- Arrestohet i dyshuari i tretë për tentimshitjen e tokës 1-milionëshe në Suharekë
- Arrestohet tre persona për bixhoz në Carrabreg të Deçanit
- Arrestohet 30-vjeçari në Ferizaj që ngacmoi seksualisht një 13-vjeçare
- Rrahu djalë e vëllain, Prokuroria në Gjakovë kërkon paraburgim për të dyshuarin
- Aktakuzë ndaj tre zyrtarëve për “keqpërdorim të detyrës” në Klinë
- Aktakuzë tre zyrtarëve të Deçanit për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”



Privacy

TË TJERA



Gomonia që ndiqej nga policia italiane, gjendet e djegur në Kurbin



Degradohet shtrati i Drinit të Bardhë në Rahovec



Arrestohet një i dyshuar në Prizren për bashkëjetesë me një të mitur



Gjilanasit i merret arma pasi shtiu në aheng familjar

